



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 11

Tiranë – E enjte, 15 janar 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 79/2025, datë 11.12.2025	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar..... 883
Dekret i Presidentit nr. 16, datë 12.1.2026	Për shpallje ligji..... 886
Ligj nr. 80/2025, datë 11.12.2025	Për disa ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar..... 886
Dekret i Presidentit nr. 17, datë 12.1.2026	Për shpallje ligji..... 887
Ligj nr. 81/2025, datë 11.12.2025	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar..... 887
Dekret i Presidentit nr. 18, datë 12.1.2026	Për shpallje ligji..... 892
Ligj nr. 82/2025, datë 11.12.2025	Për disa shtesa dhe ndryshim në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar..... 892
Dekret i Presidentit nr. 19, datë 12.1.2026	Për shpallje ligji..... 892
Ligj nr. 83/2025, datë 11.12.2025	Për disa ndryshime në ligjin nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar..... 893
Dekret i Presidentit nr. 20, datë 12.1.2026	Për shpallje ligji..... 893
Ligj nr. 84/2025, datë 11.12.2025	Për marrëveshjen e paqes fiskale..... 893

Dekret i Presidentit nr. 21, datë 12.1.2026	Për shpallje ligji.....	897
Ligj nr. 86/2025, datë 12.12.2025	Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe e detyrimeve të pagueshme në doganë.....	898
Dekret i Presidentit nr. 22, datë 12.1.2026	Për shpallje ligji.....	902
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 19, datë 9.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Sllovenisë.....	902
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 20, datë 9.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës.....	904
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 21, datë 9.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	905
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 22, datë 9.1.2026	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 1372, datë 17.12.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Sllovakisë”	906
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 95, datë 12.1.2026	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare”	907
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 96, datë 12.1.2026	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rivitalizim urban i shesheve të pallateve nr. 588, 712 etj., ‘Alex Buda’, në lagjen ‘5 Maj’, ZK 8525”	909
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 101, datë 12.1.2026	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Studim, projektim i aksit rrugor Elbasan–Lekaj, korridori 8, ‘Ndërtimi i aksit rrugor Papër–Ura e Grykshit’”	912



LIGJ
Nr. 79/2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008,
“PËR PROCEDURAT TATIMORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2006, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pikat 2, 3 dhe 4, të nenit 23, ndryshojnë si më poshtë:

“2. Vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare të administratës tatimore, drejtuar tatimpaguesit, i njoftohen atij duke ia dërguar në llogarinë e tij elektronike në sistemin tatimor “*e-filing*” dhe/apo nëpërmjet shërbimit postar rekomande.

3. Aktet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni dhe çdo korrespondencë tjetër që i dërgohet tatimpaguesit nga administrata tatimore, konsiderohen të marra nga tatimpaguesi jo më vonë se 10 ditë kalendarike pas datës së dërgimit të mesazhit elektronik apo të postës rekomande. Për njoftimet elektronike, datë e njoftimit është data e nisjes së mesazhit elektronik dhe për dokumentet e dërguara me postë rekomande, datë e njoftimit është data e pranimit të dokumentit nga shërbimi postar. Për qëllime të përcaktimit të fillimit të afatit për marrjen e akteve tatimore, sipas këtij ligji, në llogaritjen e afateve, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, nuk përfshihet dita në të cilën del akti.

4. Tatimpaguesi është i detyruar të deklarojë të dhëna të sakta të lidhura me adresën dhe postën

elektronike, në mënyrë që të sigurojë marrjen në kohë të njoftimeve.”.

Neni 2

Pas pikës 1, të nenit 40, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Veprimtaria ekonomiko-tregtare, në kuptim të këtij neni, përfshin edhe veprimtarinë e ushtruar nëpërmjet internetit. Personat fizikë, individë tregtarë e të vetëpunësuar dhe entitetet, që ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare sipas kësaj pike, duhet të publikojnë në faqen e internetit, nëpërmjet së cilës kryejnë këtë veprimtari, të dhënat e mëposhtme:

- a) numrin e NIPT-it;
- b) emrin e subjektit tregtar;
- c) adresën e selisë;
- ç) numrin e telefonit.

Kur administrata tatimore identifikon persona që ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare nëpërmjet internetit dhe nuk kanë publikuar në faqen e tyre elektronike këto të dhëna, u dërgon një njoftim zyrtar për publikimin e tyre.

Nëse brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit zyrtar nuk merren masa për publikimin e të dhënave, administrata tatimore i kërkon Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare bllokimin e përkohshëm të faqes së internetit, përmes së cilës ushtrohet aktiviteti.”.

Neni 3

Në fjalinë e dytë, të pikës 1, të nenit 41 pas togfjalëshit “sipas pikës 2, të nenit 121 të këtij ligji.” shtohen fjalitë me këtë përmbajtje:

“... si dhe masat e tjera administrative, që parashikon ky ligj për të gjitha shkeljet e konstatuara nga administrata tatimore. Për mallrat e konstatuara pa faturë bëhet rivlerësimi i TVSH-së dhe i detyrimeve përkatëse tatimore bazuar në vlerën e tregut.

Në rast të mospërmbushjes së detyrimit për regjistrim, detyrimet tatimore dhe penalitetet, që lindin sipas kësaj pike, zbatohen nga administrata tatimore ndaj tatimpaguesit individ.”.

Neni 4

Pika 7, e nenit 44 shfuqizohet.



Neni 5

Në nenin 59 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Tatimpaguesit, personat fizikë, individë tregtarë e të vetëpunësuar apo entitetet nuk mund të kryejnë ndërmjet tyre transaksione shitjeje ose blerjeje me para në dorë kur vlera e transaksionit është më e madhe se 100 000 lekë.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Personat fizikë, individë tregtarë e të vetëpunësuar apo entitetet nuk mund të kryejnë transaksione shitjeje ose blerjeje me para në dorë me individë kur vlera e transaksionit është më e madhe se 500 000 lekë.”.

Neni 6

Pas nenit 59/2, shtohet neni 59/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 59/3

Pajisja me terminal “POS/POI”

1. Tatimpaguesit që kryejnë shitje me para në dorë duhet të jenë të pajisur me terminal “POS/POI” në çdo pikë shitjeje, sipas kalendarit të mëposhtëm:

a) Brenda datës 30 maj 2026 të gjithë tatimpaguesit, të cilët:

i. ushtrojnë aktivitet ekonomik si struktura akomoduese, sipas përcaktimeve në ligjin për turizmin, dhe, konkretisht: “Bujtinë”; “Bllok apartamentesh”; “Motel”; “Fjetje dhe mëngjes”; “Hotel”; “Hotel i shpërndarë”; “Resort” dhe “Strukturë akomoduese e trashëgimisë kulturore”;

ii. ofrojnë shërbime në sektorin e transportit; si dhe

iii. institucionet publike dhe shoqëritë publike me kapital shtetëror;

b) Brenda datës 31 dhjetor 2026 të gjithë tatimpaguesit e tjerë, të përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike.

2. Përfshihen nga detyrimi i pajisjes me terminal “POS/POI”:

a) tatimpaguesit që ushtrojnë aktivitet ekonomik në zonat ku nuk ka mbulim me internet;

b) tatimpaguesit që përfshihen nga detyrimi për të lëshuar faturë, sipas ligjit për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit;

c) tatimpaguesit, të cilët përmbushin njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

i. nuk janë subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar;

ii. kanë përgjegjësi tatimore të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi;

iii. nuk kanë më shumë se një vendndodhje të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;

iv. kanë statusin/kategorinë e punësimit “I vetëpunësuar i vetëm”.

3. Terminali “POS/POI” është pajisja që bën të mundur përdorimin e kartave bankare apo të instrumenteve të tjera të pagesave elektronike në pikën e shitjes ose të ndërveprimit. Informacioni për pagesën merret nëpërmjet faturave letër nga terminallet mekanike ose elektronike.”.

Neni 7

Pika 1, e nenit 65, ndryshohet si më poshtë:

“1. Tatimpaguesi e dorëzon deklaratën tatimore në mënyrë elektronike nga llogaria e tij në sistemin informatik të administratës tatimore.”.

Neni 8

Në nenin 67 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 2 togfjalëshi “brenda 36 muajve” zëvendësohet me togfjalëshin “brenda 24 muajve”.

2. Pas pikës 4, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Deklaruesi i deklaratës vjetore të të ardhurave personale mund ta korrigjojë deklaratën e dorëzuar brenda 6 muajve nga data e dorëzimit, por jo më shumë se dy herë.”.

Neni 9

Në nenin 69 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Administrata tatimore, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e llogaritjes së vlerësimit prej saj, i dërgon tatimpaguesit njoftimin e vlerësimit tatimor dhe kërkesën për pagesën e detyrimit tatimor:

a) në rrugë elektronike, në përputhje me legjislacionin e komunikimeve elektronike, kur njoftimi i vlerësimit është nënshkruar elektronikisht; ose



b) nëpërmjet shërbimit postar rekomande në rastet kur njoftimi i vlerësimit nuk është i nënshkruar elektronikisht.”.

2. Shkronja “a”, e pikës 2, ndryshohet si më poshtë:

“a) emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit, person fizik ose emrin e entitetit, adresën e selisë dhe adresën elektronike;”.

3. Në fund të fjalisë së dytë, të pikës 4 shtohen fjalët “ose në format elektronik.”.

Neni 10

Në shkronjën “e”, të pikës 1, të nenit 71 togfjalëshi “150 000 lekë” zëvendësohet me togfjalëshin “100 000 lekë”.

Neni 11

Pas pikës 5, të nenit 71/1, shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Në rast se tatimpaguesi nuk ka dorëzuar deklaratën e TVSH-së brenda afatit të përcaktuar në ligj, sistemi elektronik i administratës tatimore, brenda 24 orëve nga përfundimi i këtij afati, plotëson dhe dorëzon automatikisht deklaratën e TVSH-së mbi bazën e të dhënave të librit të shitjes e të librit të blerjes. Përgjegjësia për çdo penalitet për mosdorëzimin e saj në afat i ngarkohet tatimpaguesit, i cili ka të drejtën ta kontrollojë, ta ndryshojë apo ta korrigjojë deklaratën sipas procedurës dhe afateve të këtij ligji.”.

Neni 12

Pas pikës 1/2, të nenit 75/1, shtohet pika 1/3 me këtë përmbajtje:

“1/3. Kërkesat për rimbursim të tatimpaguesit, për të cilin ka të regjistruar një çështje hetimore në proces, për konsumimin e veprës penale të krijimit të skemave mashtruese me TVSH-në apo fshehje të të ardhurave, parashikuar nga neni 144/a ose nga neni 180 i Kodit Penal, pezullohen deri në përfundim të veprimeve hetimore.”.

Neni 13

Pas pikës 4, të nenit 76, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Përgjashtimisht nga parashikimi në pikën 4 të këtij neni, kamatëvonesat e parashikuara nga ky ligj nuk zbatohen për njësitë e qeverisjes qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore në rastet kur mosdeklarimi brenda afatit ka ndodhur si pasojë:

a) e zbatimit të një akti ligjor apo nënligjor me efekte prapavepruese; ose

b) e zbatimit të një vendimi gjykate të formës së prerë.”.

Neni 14

Pika 4, e nenit 96, ndryshohet si më poshtë:

“4. Procedurat që do të zbatohen për shitjen e pasurisë së konfiskuar, në zbatim të aktit administrativ të konfiskimit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për financat.”.

Neni 15

Pas shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 105, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) kryerjen e verifikimit dhe vlerësimit tatimor në përputhje me përcaktimet e kreut VIII të këtij ligji, në të gjitha rastet e konstatuara të konsumimit të veprës penale të fshehjes së të ardhurave kur vlera e tatimit, taksës apo kontributit të fshehur nuk është llogaritur paraprakisht, sipas kreut X të këtij ligji. Vlerësimi tatimor dhe nxjerrja e njoftimit të vlerësimit në këto raste bëhet vetëm pas autorizimit nga drejtori i përgjithshëm i Tatimeve.”.

Neni 16

Në nenin 115/1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikat 2 dhe 3, togfjalëshi “të nenit 36, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar” zëvendësohet me togfjalëshin “të nenit 32, të ligjit nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”.

2. Në pikën 3 togfjalëshi “në nenin 36/5 të ligjit” zëvendësohet me togfjalëshin “në nenin 37 të ligjit”.

Neni 17

Shkronja “c”, e pikës 2, të nenit 116 ndryshohet si më poshtë:

“c) pikën 4, të nenit 123 të këtij ligji;”.



Neni 18

Pas pikës 2, të nenit 124/1, shtohen pikat 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:

“3. Prodhuesi ose mirëmbajtësi i *software*-it, programi i të cilit përdoret nga subjekti që lëshon fatura, që, për rastet e konfiskimit të pajisjeve fiskale, nuk bashkëpunon me administratën tatimore, me kërkesë të saj për hapjen ose verifikimin e pajisjeve, ku është instaluar ky program, dënohet me gjobë 1 000 000 (një milion) lekë për këtë shkelje.

4. Në rast se prodhuesi ose mirëmbajtësi i *software*-it, i cili është gjobitur sipas pikës 3 të këtij neni, refuzon për herë të dytë, pa shkaqe të arsyeshme, bashkëpunimin me administratën tatimore, komisioni i përhershëm për monitorimin e tyre, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, harton një relacion sqarues dhe u propozon titullarëve të institucioneve, që kanë miratuar certifikimin, marrjen e masës së shfuqizimit të certifikatës. Titullarët përkatës vendosin nëse certifikata do të shfuqizohet ose jo.”.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 16, datë 12.1.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 16, datë 12.1.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 79/2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, ‘Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ

Nr. 80/2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN
NR. 92/2014, “PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

Në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 148 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 148

**Norma e kompensimit të prodhuesit
bujqësor**

Norma e kompensimit të prodhuesve bujqësorë është 10 për qind.”.

Neni 2

Pika 3, e nenit 149, ndryshohet si më poshtë:

“3. Shuma që kompensohet është rezultat i shumëzimit të normës së kompensimit me vlerën totale të produkteve dhe të shërbimeve bujqësore, të furnizuara nga prodhuesi bujqësor, përgjatë një periudhe gjashtëmujore.”.

Neni 3

Neni 150 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 150

Mënyra e zbatimit të skemës

1. Blerësi i produkteve bujqësore, person i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në, i cili ushtron



aktivitet si grumbullues ose/dhe përpunues i produkteve bujqësore apo agroturizëm të certifikuar, sipas legjislacionit në fuqi për turizmin, lëshon një faturë tatimore për shitësin, prodhues bujqësor për çdo furnizim mallrash dhe shërbimesh të marrë prej tij. Vlera e faturës përfaqëson vlerën e furnizimit të paguar nga blerësi për llogari të shitësit, mbi të cilën aplikohet norma e kompensimit, sipas këtij ligji.

2. Forma dhe përmbajtja e faturës janë përcaktuar në nenin 101 të këtij ligji, në përputhje me natyrën e furnizimit. Në faturë duhet të shënohet NIPT-i, sipas shkronjës “ç”, të nenit 147 të këtij seksioni.

3. Kompensimi i akorduar i paguhet prodhuesit bujqësor nga administrata tatimore. Për të përfituar këtë kompensim, shitësi, prodhues bujqësor, duhet të dorëzojë në administratën tatimore, nëpërmjet shërbimit postar ose në rrugë elektronike, një kërkesë për kompensim, të shoqëruar me kopje të faturave të lëshuara nga blerësi i mallrave dhe shërbimeve bujqësore, si dhe numrin e llogarisë së tij bankare. Kërkesa për kompensim paraqitet sipas periudhave të mëposhtme:

a) brenda datës 31 dhjetor për furnizimet e kryera gjatë periudhës janar–qershor të vitit përkatës;

b) brenda datës 30 qershor të vitit pasardhës për furnizimet e kryera gjatë periudhës korrik–dhjetor të vitit paraardhës.

4. Administrata tatimore kryen kompensimin brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 17, datë 12.1.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 17, datë 12.1.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 80/2025, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 92/2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ

Nr. 81/2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 29/2023, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pika 24, e nenit 3, ndryshohet si më poshtë:

“24. “Kripto-aset” është një përfaqësim digjital i një vlere ose të drejte, i cili mund të transferohet e mund të ruhet elektronikisht përmes përdorimit të teknologjisë së regjistrave të shpërndarë ose teknologjive të ngjashme.”.



Neni 2

Pas shkronjës “d”, të nenit 8, shtohet shkronja “dh”, me këtë përmbajtje:

“dh) përjashtëmish nga përcaktimet e shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” të këtij neni, artistët, të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Shqipërisë nuk do të konsiderohen rezidentë tatimorë në Republikën e Shqipërisë për një periudhë prej 24 (njëzet e katër) muajsh nga data e hyrjes për herë të parë në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht ditëve të qëndrimit.”.

Neni 3

Pas shkronjës “f”, të nenit 11, shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje:

“g) të ardhurat nga sponsorizimet deri në masën e përcaktuar në shkronjën “p”, të pikës 1, të nenit 50, të këtij ligji.”.

Neni 4

Pas nënndarjes “ii”, të shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 12, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Ky rregull nuk zbatohet nëse individ i vetëpunësuar, pavarësisht të ardhurave të përfituara, sipas përcaktimeve të nënndarjeve “i” dhe “ii”, të shkronjës “ç”, vetëdeklaroi, në deklaratën e statusit të vetëpunësuarit, pranë drejtorisë tatimore rajonale ku është i regjistruar, se nuk është në kushtet e të ardhurave nga punësimi. Deklarata e statusit të vetëpunësuarit është sipas modelit në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij ligji, dhe dorëzohet në të njëjtën periudhë me deklaratën e tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi, brenda muajit mars të vitit tatimor. Kjo deklaratë shërben si mjet vlerësimi nga administrata tatimore, sipas ligjit të procedurave tatimore, për të përcaktuar nëse individ i vetëpunësuar nuk është në kushtet e shmangies tatimore.”.

Neni 5

Pas pikës 1, të nenit 40, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Të ardhurat nga sponsorizimet deri në masën e përcaktuar në shkronjën “p”, të pikës 1, të nenit 50 të këtij ligji, nuk konsiderohen të ardhura të tatueshme të korporatës.”.

Neni 6

Në shkronjën “p”, të pikës 1, të nenit 50, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në nënndarjen “ii”, fjalia e dytë zëvendësohet me fjalinë si më poshtë:

“Shumat e sponsorizuara, brenda kufirit të mësipërm për veprimtaritë e ekipeve sportive, pjesë të organizatave sportive, federatave sportive, komiteteve olimpike, si dhe sportistëve të nivelit të lartë, të cilët kanë fituar tituj për meritë në sport, të njohura nga legjislacioni në fuqi i fushës, për efekt të përlogaritjes së tatimit mbi fitimin e periudhës tatimore, janë të zbritshme sa trefishi i vlerës së shumës së sponsorizuar.”.

2. Nënndarja “iii” riformulohet si më poshtë:

“iii. që tejkalojnë masën 5 për qind të fitimit para tatimit për sponsorizimin e aktiviteteve për kërkim dhe zhvillim, të cilat ndërmerren me qëllim përfitimin e njohurive të reja për zhvillimin e shkencës e të teknologjisë dhe aplikimit të tyre nëpërmjet inovacionit në produkte ose në shërbime;”.

3. Pas nënndarjes “iii”, shtohet nënndarja “iv” me këtë përmbajtje:

“iv. që tejkalojnë masën 3 për qind të fitimit para tatimit për sponsorizimet e veprimtarive të tjera, që nuk përfshihen në nënndarjet “i”, “ii” dhe “iii” të kësaj shkronje.”.

Neni 7

Kudo në përmbajtje të ligjit fjalët “mjete virtuale” zëvendësohen me fjalën “kripto-aset”.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 18, datë 12.1.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj



SHTOJCA NR. 1

DEKLARATA E STATUSIT TË VETËPUNËSUARIT

1. Periudha tatimore për të cilën bëhet deklarimi: _____
2. Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT) i të Vetëpunësuarit: _____
3. Emri Tregtar i të Vetëpunësuarit: _____
4. Adresa: _____

5. Ky formular plotësohet për subjektet kontraktuese të individit të vetëpunësuar, i cili vetëdeklarohet se është në kushtet e të ardhurave nga biznesi, si më poshtë vijon:

- plotësohet për 1 kontraktues, në rastin kur 80 për qind ose më shumë e të ardhurave të fituara merren direkt ose indirekt nga një klient i vetëm; ose

- plotësohet për 2 kontraktues, në rastin kur 90 për qind ose më shumë e të ardhurave totale të fituara merren nga më pak se 3 klientë.

6. Ky formular nuk plotësohet nëse individ i vetëpunësuar ofron shërbime vetëm për persona jorezidentë në Republikën e Shqipërisë apo vetëm për entitete që nuk kanë një seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë. Në këtë rast, i vetëpunësuar automatikisht konsiderohet se realizon të ardhura nga biznesi dhe nuk është e nevojshme të plotësojë deklaratën.

7. Përshkruani profesionin tuaj.

8. Përshkruani llojin e shërbimeve të ofruara.

9. Ku e zhvillon aktivitetin tuaj? Ambienti është i marrë me qira, njësi biznesi në pronësinë tuaj, është adresa juaj e banimit, etj.? Jepni shpjegime.

10. Sa është vlera totale e të ardhurave të tatueshme të deklaruar në Deklaratën e Tatimit mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi të periudhës tatimore, për të cilën po vetëdeklarohet Deklarata e Statusit të Vetëpunësuarit?

Kontraktuesi nr. 1**Seksioni 1 - Të dhënat bazë për kontraktuesin e të vetëpunësuarit**

1. NIPT-i i Kontraktuesit nr. 1 të të vetëpunësuarit: _____
2. Emri tregtar: _____
3. Adresa: _____
4. Vlera e faturimit pa TVSH të kontraktuesit për individin e vetëpunësuar: _____

Seksioni 2 - Informacion i përgjithshëm

5. Përcaktoni kohëzgjatjen e shërbimit të ofruar.

6. Përshkruani biznesin e kontraktuesit nr. 1, të cilit i faturoni shërbimin.

7. Përshkruani detyrat/funksionet e kryera në kuadër të shërbimit të ofruar për kontraktuesin nr. 1.

Seksioni 3 - Sjellja e të vetëpunësuarit

8. A është i vetëpunësuar i detyruar të raportojë mbi punën e tij? Nëse po, përcaktoni nëse raportimi bëhet mbi bazë ditore, javore, mujore, etj.

9. Cila është frekuenca e shërbimeve? Përcaktoni nëse është ditore, javore, sipas nevojës, sipas një kalendari në ditë të dakordësuara, etj.

10. A është i vetëpunësuar i detyruar të ofrojë shërbimin personalisht? ____ Po ____ Jo (jepni shpjegime)

11. A është e mundur që i vetëpunësuar të punësojë zëvendësues apo ndihmës për dhënien e shërbimit? ____ Po ____ Jo (jepni shpjegime)

12. A përcaktohet mënyra e proceseve të punës dhe sekuenca e tyre nga biznesi kontraktues? ____ Po ____ Jo (jepni shpjegime)

13. A ka rregullore apo instruksione në bazë të të cilave i vetëpunësuar është i detyruar të kryejë shërbimet sipas këtyre rregullave apo instruksioneve të përcaktuara nga biznesi kontraktues?

14. A i reklamohet shërbimet e veta i vetëpunësuar? ____ Po ____ Jo, nëse po, në çfarë forme?

15. A është i vetëpunësuar i detyruar t'i kryejë shërbimet sipas orareve të përcaktuara nga kontraktuesi?

**Seksioni 4 - Kontrolli mbi faktorët dhe produktin e shërbimit**

16. Listoni materialet që duhen për ofrimin e shërbimit. A janë ofruar këto materiale nga individ i vetëpunësuar apo nga biznesi kontraktues?

17. Listoni pajisjet që duhen për ofrimin e shërbimit. Këto pajisje janë ofruar nga i vetëpunësuar apo nga biznesi kontraktues?

18. Ku ofrohen shërbimet? Në vendin e biznesit të të vetëpunësuarit, në vendin e biznesit të marrësit të shërbimit, diku tjetër. (Jepni shpjegime)

19. A i proceson i vetëpunësuar një pjesë të produktit të shërbimit në ambientet e tij? ☐ Po ☐ Jo, Nëse po, përshkruaj shërbimin, materialet, pajisjet e përdorura.

Nëse po, çfarë bën i vetëpunësuar me produktin apo shërbimin e përfunduar?

Seksioni 5 - Natyra e marrëdhënies

20. A është kryer puna sipas një kontrate? ☐ Po ☐ Jo

Nëse po, përshkruani kushtet e kontratës, datën dhe palët, nr./prot. të noterizimit nëse ka.

21. A është i vetëpunësuar i detyruar të kryejë shërbimet sipas orareve të përcaktuara nga biznesi kontraktues? ☐ Po ☐ Jo (jepni shpjegime)

22. Çfarë lloj pagese merr i vetëpunësuar? Shpjegoni nëse pagesa është me orë pune, javore, mujore, etj.

23. Kush vendos për vlerën e pagesës apo tarifës: i vetëpunësuar, biznesi kontraktues? (jepni shpjegime)

24. A është e mundur që i vetëpunësuar të pësojë humbje financiare nga performanca në zbatim të kësaj kontrate? ☐ Po ☐ Jo (jepni shpjegime)

25. Nëse shërbimet nuk realizohen sipas afateve të përcaktuara, a ka penalitete për vonesat?

☐ Po ☐ Jo (jepni shpjegime)

Kontraktuesi nr. 2**Seksioni 1 - Të dhënat bazë për kontraktuesin e të vetëpunësuarit**

1. NIPT-i i kontraktuesit nr. 1 të vetëpunësuarit: _____

2. Emri tregtar: _____

3. Adresa: _____

4. Vlera e faturimit pa TVSH të kontraktuesit për individin e vetëpunësuar: _____

Seksioni 2 - Informacion i përgjithshëm

5. Përcaktoni kohëzgjatjen e shërbimit të ofruar.

6. Përshkruani biznesin e kontraktuesit nr. 2, të cilit i faturoni shërbimin.

7. Përshkruani detyrat/funksionet e kryera, në kuadër të shërbimit të ofruar për kontraktuesin nr. 2.

Seksioni 3 - Sjellja e të vetëpunësuarit

8. A është i vetëpunësuar i detyruar të raportojë mbi punën e tij? Nëse po, përcaktoni nëse raportimi bëhet mbi bazë ditore, javore, mujore, etj.

9. Cila është frekuenca e shërbimeve? Përcaktoni nëse është ditore, javore, sipas nevojës, sipas një kalendari në ditë të dakordësuara, etj.

10. A është i vetëpunësuar i detyruar të ofrojë shërbimin personalisht? ☐ Po ☐ Jo (jepni shpjegime)

11. A është e mundur që i vetëpunësuar të punësojë zëvendësues apo ndihmës për dhënien e shërbimit? ☐ Po ☐ Jo (jepni shpjegime)

12. A përcaktohet mënyra e proceseve të punës dhe sekuenca e tyre nga biznesi kontraktues? ☐ Po ☐ Jo (jepni shpjegime)

13. A ka rregullore apo instruksione në bazë të të cilave i vetëpunësuar është i detyruar të kryejë shërbimet sipas këtyre rregullave apo instruksioneve të përcaktuara nga biznesi kontraktues?

14. A i reklamon shërbimet e veta i vetëpunësuar? ☐ Po ☐ Jo, nëse po në çfarë forme?

15. A është i vetëpunësuar i detyruar t'i kryejë shërbimet sipas orareve të përcaktuara nga kontraktuesi?

**Seksioni 4 - Kontrolli mbi faktorët dhe produktin e shërbimit**

16. Listoni materialet që duhen për ofrimin e shërbimit. A janë ofruar këto materiale nga individ i vetëpunësuar apo nga biznesi kontraktues?

17. Listoni pajisjet që duhen për ofrimin e shërbimit. Këto pajisje janë ofruar nga i vetëpunësuar apo nga biznesi kontraktues?

18. Ku ofrohen shërbimet? Në vendin e biznesit të të vetëpunësuarit, në vendin e biznesit të marrësit të shërbimit, diku tjetër. (Jepni shpjegime)

19. A i proceson i vetëpunësuar një pjesë të produktit të shërbimit në ambientet e tij? ____ Po ____ Jo

Nëse po, përshkruaj shërbimin, materialet, pajisjet e përdorura.

Nëse po, çfarë bën i vetëpunësuar me produktin apo shërbimin e përfunduar?

Seksioni 5 - Natyra e marrëdhënies

20. A është kryer puna sipas një kontrate? ____ Po ____ Jo

Nëse po, përshkruani kushtet e kontratës, datën dhe palët, nr./prot. të noterizimit nëse ka.

21. A është i vetëpunësuar i detyruar të kryejë shërbimet sipas orareve të përcaktuara nga biznesi kontraktues? ____ Po ____ Jo (jepni shpjegime)

22. Çfarë lloj pagese merr i vetëpunësuar? Shpjegoni nëse pagesa është me orë pune, javore, mujore, etj.

23. Kush vendos për vlerën e pagesës apo tarifës: i vetëpunësuar, biznesi kontraktues? (jepni shpjegime)

24. A është e mundur që i vetëpunësuar të pësojë humbje financiare nga performanca në zbatim të kësaj kontrate? ____ Po ____ Jo (jepni shpjegime)

25. Nëse shërbimet nuk realizohen sipas afateve të përcaktuara, a ka penalitete për vonesat?

____ Po ____ Jo (jepni shpjegime)

NËNSHKRIMI I VETËDEKLARIMIT

Deklaroj se pas vlerësimit të pyetjeve të Deklaratës së Statusit të Vetëpunësimit nuk jam në situatë shmangie tatimore në kuptim të nenit 12, shkronja “ç”, të ligjit nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe si rrjedhojë të ardhurat e deklaruar, do të deklarohen si të ardhura nga biznesi në Deklaratën e Tatimit mbi të Ardhurat Personale të Biznesit për periudhën tatimore të vitit _____

Individi i Vetëpunësuar

(emër, mbiemër, nënshkrim)

**DEKRET****Nr. 18, datë 12.1.2026****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 81/2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 29/2023, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ**Nr. 82/2025**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIM NË
LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006,
“PËR SISTEMIN E TAKSAVE
VENDORE”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 27, “Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në paragrafin 3, të pikës 2, pas fjalëve “të Këshillit të Ministrave” shtohen fjalët “në zbatim të neneve 21, pika 2, 22, pika 5, 22/1, 22/3 dhe 22/4 të këtij ligji”.

2. Në pikën 3, shkronja “a”, togfjalëshi “si dhe të ndërtimeve për qëllime publike” shfuqizohet.

3. Pas pikës 9 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

“10. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse objektet pronë e paluajtshme e shtetit dhe të destinuara për ushtrimin e funksioneve publike, me pronësi publike, të ndërtuara me financime nga buxheti i shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore apo nga investimet e enteve publike.

Përfshitimi i parashikuar në këtë nen nuk konsiderohet ulje apo heqje e taksës së të ardhurave vendore, në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 69/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 11.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 19, datë 12.1.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET**Nr. 19, datë 12.1.2026****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 82/2025, “Për disa shtesa dhe ndryshim në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ‘Për sistemin e taksave vendore’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

**LIGJ**
Nr. 83/2025**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN**
NR. 87/2019, “PËR FATURËN DHE
SISTEMIN E MONITORIMIT TË
QARKULLIMIT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në shkronjën “b”, të nenit 4, fjalët “në përputhje me legjislacionin në fuqi për sistemin e taksave vendore” zëvendësohen me fjalët “në përputhje me ligjin për tatimin mbi të ardhurat”.

Neni 2

Fjalja e dytë, e pikës 2, të nenit 9, ndryshohet si më poshtë:

“Nëse blerësi është individ i paregjistruar si subjekt për ushtrim aktiviteti tregtar, në faturë shënohet emri i tij i plotë, numri personal i identifikimit ID dhe adresa e saktë ku dërgohen mallrat.”.

Neni 3

Në pikën 2, të nenit 17, fjalët “ditën e dhjetë” zëvendësohen me fjalët “ditën e njëmbëdhjetë”.

Neni 4

Në fjalinë e parë, të pikës 10, të nenit 20, fjalët “tri ditë” zëvendësohen me fjalët “shtatë ditë”.

Neni 5

Kudo në përmbajtjen e ligjit fjalët “tatimit mbi fitimin” zëvendësohen me fjalët “tatimit mbi të

ardhurat e korporatës” dhe fjalët “tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” zëvendësohen me fjalët “tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 20, datë 12.1.2026,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 20, datë 12.1.2026**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 83/2025, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 87/2019, ‘Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit’, i ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 84/2025**PËR MARRËVESHJEN E PAQES**
FISKALE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHMENeni 1
Objekti i ligjit

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave për lidhjen e marrëveshjes vullnetare ndërmjet tatimpaguesit dhe administratës tatimore për pagimin e tatimit mbi të ardhurat e korporatave ose të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi, bazuar në vlerësimin e fitimit të tatueshëm, si dhe të drejtën për rivlerësimin e pasqyrave financiare të tri viteve të mëparshme.

Ky ligj nuk sjell asnjë lloj imuniteti administrativ, tatimor ose penal ndaj veprimeve të tatimpaguesve për pastrimin e parave, financimin e terrorizmit apo për çdo veprë tjetër penale që lidhet me origjinën e paligjshme të pasurisë. Administrata tatimore informon rastet e dyshimeve të arsyeshme pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare.

Neni 2
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është të nxisë përmbushjen vullnetare të detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat e korporatave ose tatimin mbi të ardhurat personale nga biznesi, si dhe rivlerësimin e pasqyrave financiare nëpërmjet një marrëveshjeje njëvjeçare, kundrejt mosushtimit të kontrollit tatimor për këtë tatim gjatë vitit tatimor të marrëveshjes.

Neni 3
Fusha e zbatimit të ligjit dhe kohëzgjatja e marrëveshjes së paqes

1. Ky ligj zbatohet për tatimpaguesit, që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët:

a) janë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

b) i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat e korporatave ose tatimit mbi të ardhurat personale

nga biznesi sipas dispozitave të ligjit për tatimin mbi të ardhurat dhe nuk përfitojnë nga normat e reduktuara, e përjashtimet sipas nenit 69, të ligjit nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar;

c) përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj e në aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Marrëveshja e paqes fiskale zbatohet për një vit tatimor, me të drejtë rinovimi për 2 (dy) vite tatimore.

Neni 4
Përkufizime

